



Prishtinë: 29.01.2008

Kodi i ZRRE-së: V_156_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_173_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_173_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Fehmi Shala (shifra e konsumatorit DPR - 90024180) nga Kastrioti, si arsytet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të datës 17.07.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 02.07.2007, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë.

- Me datë 21.04.2001 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 17676837.
Provë: Procesi i pranimit të instalimit të KEK-ut nr. 416/2001 të datës
- Me datë 29.08.2003 konsumatori ka nënshkruar kontratën për shërbime të energjisë.
Provë: Kontrata për shërbimet e energjisë elektrike e datës 29.08.2003
- Me datë 25.02.2005 ekipi i kontrollës së KEK-ut ka përpiluar Procesverbalin nr. 000682 në të cilin është shkruar se konsumatori ka të montuar njehsorin elektrik, dhe i ka dy lidhje direkte të cilat nuk kalojnë nëpër pikën matëse, po në këtë proces janë regjistruar pajisjet elektrike të cilat kanë qenë shfrytëzim në këtë konsumatori.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000682 i datës 28.02.2005
- Bazuar në procesin e ekipit të kontrollit nr. 000682, me datë 09.03.2005 KEK Sh.A – Distribucioni i Prishtinës – Divizioni i Furnizimit – Departamenti i Shitjes – Sektori i Faturimit e ngarkon konsumatorin me anë të faturës nr. 159 në shumë prej 1,844.74 €. **Provë:** Fatura e KEK-ut nr. 159
- Me datë 11.03.2005 KEK-u me anë të Urdhër Lejimit / Ngarkimit nr. 8682 ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPR – 90024180 në shumë prej 1,844.74 €, në të cilin urdhër lejim/ngarkim ceket se “faturë e harxhimit të paautorizuar sipas procedurës të kontrollës”. **Provë:** Urdhër Lejimi / Ngarkimi i KEK-ut nr. 8682 i datës 11.03.2005



- Me datë 08.12.2006 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 02.07.2007 KEK-u – Departamenti për Konsumator iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut
- Me datë 17.07.2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK-u dhe konsumatori, ka vërejtur se:

- ✓ Sipas procesverbalit nr. 000682 shihet se konsumatori ka pasur lidhje tjera direkte jashtë pikës matëse të paautorizuara nga ana e KEK-ut.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000682 të datës 25.02.2005
- ✓ Me vendosjen e dy lidhjeve direkte jashtë pikës matëse, konsumatori ka bërë shkelje të procedurave dhe rregullave në fuqi – shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike.
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit ceket se ai është i kyçur në rrjetin elektrik që nga viti 2001 dhe se sipas tij njehsori ka qenë në rregull i vulosur (bllombuar) dhe se të gjitha pajisjet në lokalit e tij kanë qenë të kyçura në njehsor.
Provë: Deklarata e konsumatorit
- ✓ Llogaritja nga ana e KEK-ut e konsumit të paautorizuar të energjisë, nuk është bërë në pajtim me procedurën në fuqi.
Provë: Llogaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar
- ✓ Duke analizuar rrjedhjen e energjisë aktive të konsumatorit vërehet se konsumi mujor i konsumatorit është shumë i ulët për një lokal të tillë, ku shihet se para ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar konsumi mesatar mujor gjatë verës ka qenë **164.12 kWh**, kurse gjatë dimrit konsumi mesatar mujor është **198.33 kWh**, që do të thotë se për një konsumator të tillë komercial konsumi mujor është jashtëzakonisht i ulët.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive
- ✓ Procesi i përgatitur nga ekipi i kontrollit në teren është i mangët, ngase nuk është theksuar se cilat pajisje kanë qenë të lidhura në këto lidhje direkte, apo këto lidhje kanë qenë të lira për kyçje të pajisjeve të ndryshme, por vetëm janë regjistruar të gjitha pajisjet në këtë punëtori.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura nga palët i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së,



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar